V E N D I M
Nr.454, datë 23.9.1999

PËR NDRYSHIMIN E TARIFAVE NË SHËRBIMET POSTARE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5 të ligjit nr.7581, datë 7.7.1992 "Për çmimet dhe tarifat", me propozimin e Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1.Tarifat në shërbimet postare rriten mesatarisht 30 për qind

2. Drejtoria e Përgjithshme e Postave dhe Telekomunikacioneve të bëjë zbërthimin analitik të tarifave për çdo lloj shërbimi.

3. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.530, datë 19.8.1996 "Për ndryshimin e tarifave në shërbimet postare dhe miratimin e tarifave për shërbimet e reja", shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko